REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1606 Prot Tiranë, më 14 / 10/2019

REKOMANDIM

Nr. 46, datë 14 / 10/2019

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS SË AUTORITETIT PUBLIK "ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA"

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*", shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

1. Në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare http://www.erru.al/mat.php?idr=93&idm=281&lang=1, të Autoritetit Publik "Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura". (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të po të njëjtës dispozitë, në përgatitjen e programit të transparencës, Autoriteti Publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;

b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;

c) modelet e miratuara për kategorinë e Autoritetit Publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të programit të transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo Autoritet Publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, u krye monitorimi me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të Autoritetit Publik. Nga monitorimi rezultoi se, Autoriteti Publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në "Publikime", në të cilën programi i transparencës shfaqet si një nën menu.

Nga verifikimi i rubrikave të programit rezultoi se, kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik pa kërkesë në përputhje me nenin 7 të ligjit, janë pasqyruar në mënyrë jo të plotë në programin e transparencës.

Programi i transparencës duhet të jetë i plotësuar me të gjithë elementët sikurse parashikohet në ligj, si dhe i plotësuar me informacion specifik sipas fushës së veprimtarisë së çdo autoriteti publik.

Në lidhje me monitorimin e kryer Zyra e Komisionerit vlerëson se, problematikat e evidentuara konsistojnë në mosvënien në zbatim të programit të transparencës, në përputhje me modelin e miratuar nga Komisioneri.

Nga monitorimi u konstatua se nuk është publikuar informacioni në përputhje me nenin 7 pika 1 e ligjit, konkretisht për germat:

gj) *çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;*

h) *një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë.*

Disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 e ligjit, gjenden të publikuara në rubrika të tjera të faqes por, nuk janë të ndërlidhura me tabelën e programit (të pa linkuar), ose citohen por janë të pa aksesueshme. Konkretisht si më poshtë:

c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës (linku nuk ndërlidhet me informacionin e cituar);

ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit (linku nuk ndërlidhet me informacionin e cituar);

***dh)** mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;*

***e)** të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara (nuk është publikuar buxheti për vitin 2019) ;*

***ë)** informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;*

***f)** informacion për shërbimet që Autoriteti Publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;*

***l)** çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga Autoriteti Publik.*

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi, u hartua raporti i monitorimit.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se një pjesë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet ti përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*", shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*, i ndryshuar,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në zbatim të gërmave a), b), c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të rishikojë/përditësojë programin e transparencës;
2. Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit;
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni;
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit".

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 14.10.2019

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE TIRANË

Raport monitorimi mbi implementimin e programit të transparencës së Autoritetit Publik/ Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Larmgimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura– datë 11.10.2019

1. **Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)** ka publikuar programin e transparencës në faqen zyrtare në linkun: http://www.erru.al/mat.php?idr=93&idm=281&lang=1. Nga monitorimi i faqes rezulton se, autoriteti publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në "Transparenca", nën menu-në "Programi i transparencës", rubrika "Programi i transparencës" ku është ndërlidhur programi i transparencës.



2. Programi i transparencës është i publikuar në përputhje me programin model të transparencës të miratuar sipas Urdhërit nr.14 date 22.01.2015. Nga monitorimi rezulton se

kategoritë e informacionit të programit model të transparencës janë të ndërlidhura (të linkueshme) me faqen kryesore në të cilën ndodhet informacioni.



TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË ENTIT RREGULALTOR TË UJIT

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti /Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Sektori Përgjegjës për përgatitjen e materialit apo disponimin e tij
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të Entit Rregulator të Ujit	Ligji 119/2014, "Për të drejtën e informimit", neni 7/1/a/ii	Kush jemi ne Vendimi i Këshillit nr 34/2016 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregulator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Larguimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura(ERRU)" Struktura Organigrama	Pas botimit në Fletoren Zyrtare. Përditësohet pas çdo ndryshimi ligjor	Në faqen zyrtare, në menunë "Rreth nesh"	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
Akte rregullatore ligje akte nën ligjore dokumente politikash dokumente tjetër	Ligji 119/2014, "Për të drejtën e informimit", neni 7/1/a/ii	Kornizës Ligje Akte nënligjore Strategji Rregullore dhe Metodika të ERRU Raporte të ERRU Kodi i integritetit Vendime të Komisionit	Pas botimit në Fletoren Zyrtare. Pas miratimit si vendimet nga Komisioni Koordinator i Entit Rregulator të Ujit	Në faqen zyrtare, në menunë "Legjislacion" Në faqen zyrtare, në menunë "Raporte" Në faqen zyrtare, në menunë "Legjislacion" Në faqen zyrtare, në menunë	Entit Rregulator i Ujit dhe institucione të tjera

7.1.a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik. **Informacioni gjendet i publikuar në faqen kryesore dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**



LIGJ
Nr.8102, datë 28.3.1996

PËR KUADRIN RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT DHE PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Ndryshuar me:
- *Ligjin nr.9352, datë 03.03.2005*
- *Ligjin nr.9584, datë 17.07.2006 (i ndryshuar me ligjin nr.9845, datë 17.12.2007)*
- *Ligjin nr.9915, datë 12.05.2008*

Ne mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Keshillit te Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i këtij ligji

VENDIM
Nr. 34/2016

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shperblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të parashtra, të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU),

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Struktura e ERRU-së është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur.

II. Organika e ERRU-së është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur.

III. Numri i punonjësve është 28.

IV. Vendimi nr. 94, datë 30.4.2015, "Për miratimin e strukturës, dhe organikës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)", e ndryshuar me vendimin nr. 162, datë 28.2.2008, shfuqizohet.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 28.4.2016

STRUKTURA ORGANIZATIVE E ERRU-SË

STRUKTURA ORGANIZATIVE E ERRU-SË



FAQJA KRYESORE
KRETH NESH
TRANSPARENCA
LEGJISLACIONI
VENDIME TË KKRR
LICENCIM
MONITORIMI
TARIFAT
RAPORTET
KONSUMATORËT
SEKTORI UK
LAJME
PUBLIKIMET

HOME > KRETH NESH > Çfare bejme ne

SITEMAP KONTAKT

Çfare bejme ne

LAJME

Komisioni Kombëtar Rregullator me vendim Nr. 37, datë 10.07.2018 vendosi të licencojë njësjellës kanalizime Mallakastër sh.a

Komisioni Kombëtar Rregullator me vendim Nr. 34, datë 10.07.2018 vendosi për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 06.10.2017, "Për licencimin e sh.a njësjellës Gramsh", i ndryshuar

FAQJA KRYESORE
KRETH NESH
TRANSPARENCA
LEGJISLACIONI
VENDIME TË KKRR
LICENCIM
MONITORIMI
TARIFAT
RAPORTET
KONSUMATORËT
SEKTORI UK
LAJME
PUBLIKIMET

Kush jemi ne

LAJME

Komisioni Kombëtar Rregullator me vendim Nr. 43, datë 20.09.2018 vendosi të licencojë njësjellës kanalizime Himarë sh.a

Komisioni Kombëtar Rregullator me vendim Nr. 37, datë 10.07.2018 vendosi të licencojë njësjellës kanalizime Mallakastër sh.a

Komisioni Kombëtar Rregullator me vendim Nr. 34, datë 10.07.2018 vendosi për një

FAQJA KRYESORE
KRETH NESH
TRANSPARENCA
LEGJISLACIONI
VENDIME TË KKRR
LICENCIM
MONITORIMI
TARIFAT
RAPORTET
KONSUMATORËT
SEKTORI UK
LAJME
PUBLIKIMET

HOME > KRETH NESH > Bashkëpunetorë >

SITEMAP KONTAKT

Me kë bashkëpunojmë ne

Bashkëpunetorë Kombëtarë janë

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)
  - Agencia Kombëtare Njësjellës Kanalizimeve (AKUK)
    - Nëllsa e Kualitetit (Benchmarking)
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
  - Komisioni i Mbrojtjes se Konsumatorëve
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Ambientale (MSHMA)
  - Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)
- Autoriteti i Konkurrencës
- Inspektorati Europian i Trajtimit

Bashkëpunetorë Ndërkombëtarë janë

- Autoriteti Rregullator per Shërbimet e Ujit (ARRUK), Republika e Kosovës
- Entidade Reguladora - Portugaleze (Entidade Reguladora dos Serviços de Agua e Residuos) Portugal

LAJME

ndryshim ne vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 47, datë 12.06.2018, "Për licencimin e sh.a njësjellës kanalizime Dibër"

Komisioni Kombëtar Rregullator me vendim Nr. 43, datë 20.09.2018 vendosi të licencojë njësjellës kanalizime Himarë sh.a

Komisioni Kombëtar Rregullator me vendim Nr. 37, datë 10.07.2018

7.1.b) tekstet e plota: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë. **Informacioni gjendet i publikuar në faqe dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**







Fletorja Zyrtare — Viti 2018 – Numri 52

VENDIM
Nr. 73, datë 7.2.2018

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE, 2018–2027

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të shkronjës "b", të pikës 4, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratohet "Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2018–2027", sipas aktit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen organet përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe të gjitha institucionet e përfshirë në zbatim e kësaj strategjie për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

7.1.c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës. **Informacioni është i publikuar në faqe dhe është i ndërlidhur në programin e transparencës;**



KËRKESË PËR INFORMACION

Emër Mbiemër: Z. Zj.	Adresa postare: Adresa elektronike: Nr. Tel	Data: __/__/201_ Nënshkrimi:

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokumentin identifikimi të skanuar)

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Të tjera të dhëna

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni:

7.1.ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit. **Informacioni është i publikuar në faqe,**



7.1.d) një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime. **Informacioni gjendet i publikuar në menu-në "Program i Transparencës" dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**





7.1.dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit. **Informacioni është i publikuar në faqen e autoritetit.**





7.1.e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara. **Informacioni është publikuar në faqe dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës.**


Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë
dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
Një sektor ujësjellës-kanalizimesh financiarisht i vetë-qëndueshëm që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme, për të gjithë konsumatorët në Shqipëri.
FAQJA KRYESORE
RRETH NESH
TRANSPARENCA
LEGJISLACIONI
VENDIME TË KKRR
LICENCIMI
SITEMAP
KONTAKT
GO
Bushati
Raport monitorimi financiar
Prokuroria
Enti Rregullator i Ujit publikon raportin e Bilancit Vjetor i Ujit te shoqerive UK per vitin 2018
LAJME
12.06.2018, "Per licensimin e sh.a. ujesjelles kanalizime Dibar"
Komisioni Kombetar
11:07 PM
10/11/2019


Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë
dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
Një sektor ujësjellës-kanalizimesh financiarisht i vetë-qëndueshëm që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme, për të gjithë konsumatorët në Shqipëri.
FAQJA KRYESORE
RRETH NESH
TRANSPARENCA
LEGJISLACIONI
VENDIME TË KKRR
LICENCIMI
MONITORIMI I
TARIFAT
RAPORTET
KONSUMATORËT
SEKTORI UK
LAJME
SITEMAP
KONTAKT
GO
Raport monitorimi financiar
Enti Rregullator i Ujit publikon raportin e Bilancit Vjetor i Ujit te shoqerive UK per vitin 2018
LAJME
Nr. 44, date 20.09.2018 vendosi per nje ndryshim ne vendimin e Komisionit Kombetar Rregullator nr. 47, date 13.06.2018, "Per licensimin e sh.a.
11:10 PM
10/11/2019

ENTI RREGULLATOR I UJIT
Drejtoria Shërbimeve Mbështetëse
Sektori Burimeve Njerëzore dhe Financiare

RAPORT
MBI VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE TË ERRU

Dhjetor 2018

BUXHETI

Në përmbushje të detyrave funksionale, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse gjatë katërmujorit të dytë ka punuar për të garantuar mbështetjen e plotë logistike për ndërtimin e veprimtarisë së institucionit, për monitorimin vazhdueshëm të planit të shpenzimeve për realizimin e të ardhurave të financuara si dhe për menaxhimoshërtorin e vlerave materiale e monetare në përdorim.

Plani i shpenzimeve operative vjetore të ERRU për vitin 2018, është miratuar me VKM nr. 26, datë 17.01.2018, "Për miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2018, për Entin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" dhe me total është në shumën 49 649 000 leka.

Detajimin e planit të shpenzimeve operative në përputhje me kuotat e miratuar nga KM është me kompetencë të KKRR, ndaj në muajin janar, me vendimin e Komisionit nr. 3, datë 24.01.2018, u detajuan kuotat e shpenzimeve sipas artikujve, në përputhje me nevojat e institucionit.

Gjatë viti 2018 është monitoruar rregullisht vecoria e tërësisë së pagesave rregullatore, pendesimi e limiteve të miratuara në plani e detajuar të shpenzimeve, përmes zbatimit të procedurave të prokurimit publik.



ENTI RREGULLATOR I UJIT

PLANI I DETAJUAR I SHPENZIMEVE OPERATIVE PËR VITIN 2019

Miratuar me VKM nr. 3, datë 09.01.2019

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Lekë
1	Paga dhe shtesa të tjera	28 035 000
2	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	4 397 000
3	Shërbime Furniture	11 882 000
4	Investime	1 080 000
	TOTALI	**45 394 000**





7.1.ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;- **Informacioni është i publikuar në faqe dhe është ndërlidhur në programin e transparencës, linku për regjistrin e parashikimit të prokurimeve nuk është i aksesueshëm.**


Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë
dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
FAQJA KRYESORE
RRETH NESH
TRANSPARENCA
LEGJISLACIONI
VENDIME TË KKUR
LICENCIMI
MONITORIMI
TARIFAT
RAPORTET
KONSUMATORËT
SEKTORI UK
LAJME
Prokurime
LAJME


Regjistri i realizimeve të prokurimit publik



7.1.f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit - **Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqe dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit model të transparencës.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

VENDIM
Nr. 21, datë 30.03.2018

PËR
TARIFAT E DHËNIES SË INFORMACIONIT (DOKUMENTACIONIT) TË KËRKUAR

Në mbështetje të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Tarifat e shërbimit të dhënies së informacionit (fotokopje ose CD) të jenë si më poshtë:

a) Deri në 10 fletë informacioni përfitohet pa pagesë,
b) Mbi 10 fletë për formatin A4 pagesa do të jetë 5 (pesë) leke/fletë,
c) Për informacionin e dhënë me CD, pagesa do të jetë 60 (gjashtëdhjetë) leke/CD.

2. Specialisti perkatës i sektorit i cili do të përgatisë informacionin e kërkuar, në bashkëpunim

7.1.g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik. **Informacioni është i publikuar në faqe dhe është ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura

Një sektor ujësjellës-kanalizimesh financiarisht i vetë-qëndrueshëm që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme, për të qëlltë konsumatorët në Shqipëri.

FAQJA KRYESORE
RRETH NESH
TRANSPARENCA
LEGJISLACIONI
VENDIME TË KËSHILLIT
LICENCIMI
MONITORIMI
TARIFAT
RAPORTET
KONSUMATORËT

HOME > KONSUMATORËT > Ankesat

SITEMAP KONTAKT

Ankesat

Enti Rregullator i Ujit publikon raportin e Bilancit Vjetor i Ujit te shoqërive UK per viten 2018

LAJME

nënyshtë ne vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, date 06.10.2017, "Per licensimin e sh.a. ujësjellës Gramsh", i ndryshuar

Enti Rregullator i Ujit

Rregullorja_per_Proceduren_e_Ankimimit_2019.pdf 1 / 10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

RREGULLORE MBI PROCEDURËN E ANKIMIT NË KOMISIONIN KOMBËTAR RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA, PËR NJË TË LICENCUAR



7.1.gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik; - **Informacioni nuk është i publikuar në faqe pavarësisht se në tabelën e programit model të transparencës është ndërlidhur një link i cili nuk aksesohet.**

7.1.h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; - **Informacioni nuk është i publikuar në faqe;**

7.1.i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji - **Informacioni është i publikuar në menu-në "Publikimet", nën menu-në "Programi i transparencës", rubrika "Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve" dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës. Përditësimi i regjistrit datë 06.06.2019.**



ENTI RREGULLATOR I UJIT

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE MBI TË DREJTËN E INFORMIMIT

2019

Nr.	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti (Përmban edhe përmbledhje të kërkesës)	Data e kthimit të përgjigjes (Përmban edhe përmbledhje të përgjigjes)	Statusi i kërkesës	Tarifa
1	02.04.2019	Kërkesë për informacion Mbi emrinin e shërbimit si furnizimi me ujë në Kosovë për periudhën prill 1994-dhjetor 2002 dhe në Tiranë për periudhën janar 2003-dhjetor 2007	03.04.2019	U përfundua	Nuk ka
2	29.05.2019	Kërkesë për informacion mbi proceduren e ndjekur për poeicionin e liri Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse	06.06.2019	U përfundua	Nuk ka

7.1.k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh– **Informacioni është i publikuar në faqe dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**





	Buxheti	Ligji 119/2014, "Për të drejtën e informimit", neni 7/1/e	Buxheti Raporte	të Vendimit të Kës Ministrave për mi buxhetit të ERRU
	Informacion për procedurat e prokurimit	Ligji 119/2014, "Për të drejtën e informimit", neni 7/1/ë	Regjistri prokurimeve	Menjëherë pas dë APP
	Shërbimet e autoritetit për publikun	Ligji 119/2014, "Per te drejten e informimit", neni 7/1/f	Tarifat e dhënies së informacionit Regjistri njoftimeve Faturë arkëtimi	Përditësim periodi E përhershme
	Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj	Ligji 119/2014, "Për të drejtën e informimit", neni 7/1/gj	Projekt akt ligjor/nënligjor/strategji	Menjëherë pas në relacionit
	Mbajtja e dokumentacionit nga AP			
	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014	Ligji 119/2014, "Për të drejtën e informimit", neni 7/1/i	Tabelë	Pas miratimit të Pr transparencës
			Raporte	

7.1.l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik – Përgjithësisht faqja zyrtare e autoritetit është e pasur me informacion. **Informacioni është publikuar faqe dhe është ndërlidhur në tabelën e programit model të transparencës.**



Autoriteti Publik	ERRU
Programi i transparencës	Po
Koordinatori	Po
7.1.aPërshkrim/struktura, funksionet dhe detyrate A.P	Po
7.1.b Tekst. e plota të konventa, ligje, akteve	Po

7.1.c Procedura për kërkesë për informacion	Po
7.1.ç Të dhënat e vendodhjes së AP	Po
7.dTë dhënat për arsim,pagat	Po
7.1.dh Auditi	Pjesërisht
7. 1.e Buxheti	Po
7.ë Procedurat e Prokurimit	Pjesërisht
7.1.f Shërbimet e A.P	Po
7.1.g Procedura për ankesë për veprimtarinë e AP	Po
7.1.gj Mekanizma për dhënien e mendimeve	Jo
7.1.h Mbajtja e dok(Arkiva)	Jo
7.i Regjistri i kërkesave	Po
7.1.k Dokumente që kërkohen shpesh	Po
7.1.l Çdo Informacion i dobishëm	Pjesërisht